

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: : **KOMUNA PARTESH**

Nr i Prokurimit **658-26-6534-5-2-1**

Sa i përket tenderit për **Renovimi i qendrës kulturore në Partesh**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

NNP''CTA''SHPK

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

rr.Mehmet Gradica hy2 nr6

(Adresa)

Prishtine

10000

(Vendi)

(Kodi postar)

+383-44-507719

(Numri Telefonit)

(Numri)

ZIJA MORINA

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

nnpcta@gmail.com

(Adresa elektronike)

07.09.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

*Ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me tenderin “Renovimi i qendrës kulturore në Partesh”. Njoftimi për Kontratë është publikuar më datë 06.08.2026. Kërkesa për Rishqyrtim lidhur me kriteret e Dosjes së Tenderit është parashtruar më datë 20.08.2026. **Autoriteti Kontraktues e ka nxjerrë vendimin më datë 26.08.2026.***

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Hapja është bërë në platformën e prokurimit

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Me datën **20.08.2026**, NNP “CTA” SH.P.K. ka paraqitur Kërkesë për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues – Komuna e Parteshit, lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Renovimi i qendrës kulturore në Partesh”**, me nr. të prokurimit **658-26-6534-5-2-1**.

Më **21.08.2026**, Autoriteti Kontraktues ka nxjerrë vetëm vendimin për pezullimin e aktivitetit të prokurimit. Ky vendim nuk përbënte vendim merititor lidhur me miratimin apo refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim.

Sa i përket afatit për vendimmarrje të Autoritetit Kontraktues, Kërkesa për Rishqyrtim është paraqitur më **20.08.2026**. Afati fillestar prej tri (3) ditësh pune është llogaritur si vijon: **21.08.2026 – dita e parë e punës; 24.08.2026 – dita e dytë; 25.08.2026 – dita e tretë dhe e fundit e afatit fillestar**. Datat **22.08.2026 dhe 23.08.2026**, si ditë vikendi, nuk janë llogaritur si ditë pune.

Rrjedhimisht, afati fillestar prej tri (3) ditësh pune ka përfunduar më **25.08.2026**. Deri në përfundimin e këtij afati, AK nuk kishte nxjerrë vendim merititor mbi Kërkesën për Rishqyrtim dhe as nuk kishte njoftuar ankuesin për ndonjë zgjatje të afatit. Vendimi merititor i AK-së është publikuar vetëm më **26.08.2026**. Këto rrethana janë ngritur edhe si pretendim procedural në ankesë.

Për rrjedhojë, ankuesi konsideron se Autoriteti Kontraktues ka shkelur **nenin 108/A paragrafi 6 të LPP-së dhe nenin 61.3 të Rregullores për Prokurimin Publik**, duke mos nxjerrë vendimin brenda afatit fillestar ligjor dhe duke mos e njoftuar Operatorin Ekonomik për zgjatjen eventuale të këtij afati.

Sa i përket afatit për paraqitjen e kësaj ankesë pranë OSHP-së, Vendimi i Autoritetit Kontraktues mbi Kërkesën për Rishqyrtim është publikuar më **26.08.2026**. Afati ligjor prej dhjetë (10) ditësh për ankim llogaritet nga dita pasuese e publikimit të vendimit, përkatësisht:

27.08 – dita 1;

28.08 – dita 2;

29.08 – dita 3;

30.08 – dita 4;

31.08 – dita 5;

01.09 – dita 6;

02.09 – dita 7;

03.09 – dita 8;

04.09 – dita 9;

05.09.2026 – dita 10. Dite e shtune

Dita e dhjetë, **05.09.2026**, ka rënë ditë e shtunë. Për këtë arsye, afati përfundon në ditën e parë pasuese të punës, përkatësisht më **07.09.2026**. Rrjedhimisht, **kjo ankesë e paraqitur më 07.09.2026 konsiderohet e paraqitur brenda afatit ligjor për ankim pranë OSHP-së**. Dosja e tenderit përcakton se ankesa pranë OSHP-së dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të AK-së në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Për pasojë, me këtë ankesë i kërkohet OSHP-së që, përveç shqyrtimit në meritë të të gjitha pretendimeve ankimore të paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim, të konstatojë edhe shkeljen procedurale të Autoritetit Kontraktues lidhur me mosrespektimin e afatit ligjor për nxjerrjen e vendimit.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK gjate vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve nuk ka zbatuar me përpikëri të gjitha dispozitat e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Përpos kësaj AK nuk ka respektuar as kërkesat e dosjes së tenderit të cilat vetë i ka parashtruar në fillim të këtij procesi të prokurimit. Dispozitat që ne mendojmë se AK i ka shkelur janë:

Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës:

- Neni 7;
- Neni 28;
- Neni 51;
- Neni 69.

Rregulloren për Prokurimin Publik Nr. 001/2022, të ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 002/2024:

- Neni 19.3;
- Neni 19.4;
- Neni 19.5;
- Neni 19.16;
- Neni 25.17;
- Neni 25.18.
- **nenit 61.1 të Rregullores për Prokurimin Publik**
- **nenit 61.3 të Rregullores për Prokurimin Publik**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Gjatë shqyrtimit të Dosjes së Tenderit kemi konstatuar se një numër i kërkesave dhe specifikimeve teknike janë përcaktuar në mënyrë kufizuese, joproporcionale dhe pa arsytim të mjaftueshëm teknik, duke krijuar pengesa të panevojshme për pjesëmarrjen e Operatorëve Ekonomikë dhe duke cenuar konkurrencën efektive në këtë procedurë të prokurimit.

Konsiderojmë se kriteret e tilla, në formën siç janë përcaktuar, nuk janë në përputhje me parimet themelore të prokurimit publik, veçanërisht me parimin e trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit, proporcionalitetit dhe sigurimit të konkurrencës së lirë dhe efektive, si dhe bien ndesh me dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik dhe legjislacionit sekondar në fuqi.

Për këtë arsye, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që t'i rishqyrtojë kriteret dhe specifikimet e kontestuara dhe t'i ndryshojë ato në mënyrë që të eliminohen kufizimet e pajustificuara dhe të sigurohet pjesëmarrje e barabartë, e hapur dhe gjithëpërfshirëse e Operatorëve Ekonomikë.

Në vijim paraqesim në mënyrë të veçantë pretendimet tona lidhur me secilën kërkesë të kontestuar.

Pretendimi ankimor nr. 8

Mosrespektimi nga Autoriteti Kontraktues i afatit ligjor për nxjerrjen e vendimit mbi Kërkesën për Rishqyrtim

*NNP "CTA" SH.P.K. më datë 20.08.2026 ka paraqitur përmes platformës së e-Prokurimit **Kërkesë për Rishqyrtim** lidhur me Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit për aktivitetin e prokurimit **"Renovimi i qendrës kulturore në Partesh"**, me nr. të prokurimit **658-26-6534-5-2-1**.*

*Pas paraqitjes së Kërkesës për Rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues, më datë 21.08.2026, ka nxjerrë vetëm **Vendimin mbi pezullimin e aktivitetit të prokurimit**. Ky vendim nuk përbën vendim meritator mbi miratimin apo refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, por vetëm formalizon pezullimin e procedurës. Edhe dokumentacioni i ankuesit e ka evidentuar këtë dallim.*

Sipas nenit 108/A paragrafi 6 të LPP-së, Autoriteti Kontraktues duhet ta shqyrtojë Kërkesën për Rishqyrtim brenda tre (3) ditëve të punës nga data e dorëzimit të saj. Vetëm në raste specifike dhe të justifikuara ky afat mund të zgjatet për jo më shumë se tri ditë shtesë, me kusht që ankuesi të informohet për zgjatjen.

Të njëjtin detyrim e përcakton neni 61.3 i Rregullores për Prokurimin Publik.

Në rastin konkret, afati fillestar është llogaritur në këtë mënyrë: 20.08.2026 – dita zero; 21.08.2026 – dita e parë e punës; 24.08.2026 – dita e dytë e punës; 25.08.2026 – dita e tretë e punës.

Rrjedhimisht, afati fillestar prej tri ditësh pune ka përfunduar më 25.08.2026.

Deri në përfundimin e këtij afati, Autoriteti Kontraktues nuk kishte nxjerrë dhe publikuar vendim mbi miratimin apo refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim dhe NNP “CTA” SH.P.K. nuk ishte njoftuar për ndonjë zgjatje të afatit.

Madje, në dokumentacionin e ankuesit është evidentuar se edhe më 26.08.2026, para publikimit të vendimit, Kërkesa për Rishqyrtim vazhdonte të figuronte në e-Prokurim pa vendim dhe pa njoftim për zgjatje.

Vetëm më datë 26.08.2026, pra pas skadimit të afatit fillestar prej tri ditësh pune, Autoriteti Kontraktues ka nxjerrë vendimin meritore me të cilin Kërkesa për Rishqyrtim është refuzuar si e pabazuar.

Për rrjedhojë, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 108/A paragrafi 6 të LPP-së dhe nenin 61.3 të Rregullores, pasi nuk ka nxjerrë vendimin brenda afatit fillestar ligjor dhe nuk e ka njoftuar ankuesin për ndonjë zgjatje të justifikuar të afatit.

Fakti se AK e ka nxjerrë vendimin më 26.08.2026 nuk e eliminon shkeljen procedurale të krijuar nga mosrespektimi i afatit. Nxjerrja e mëvonshme e vendimit nuk mund ta sanojë në mënyrë retroaktive mosrespektimin e një afati procedural që tashmë kishte skaduar.

Kjo qasje është në përputhje edhe me praktikën e OSHP-së. Në lëndën 2024/0210, ekspertja shqyrtuese ka konstatuar shkelje të nenit 108/A paragrafi 6 pikërisht për shkak se AK nuk kishte vendosur brenda tri ditëve dhe nuk kishte njoftuar për zgjatje.

Në të njëjtën kohë, ekzistenca e kësaj shkeljeje procedurale nuk e ndryshon faktin se objekt i kësaj ankese është Vendimi konkret i AK-së i datës 26.08.2026, i cili duhet të shqyrtohet në meritë nga OSHP-ja.

Për këtë pretendim kërkojmë nga OSHP-ja që të konstatojë mosrespektimin e afatit ligjor nga Autoriteti Kontraktues dhe të vazhdojë me shqyrtimin meritore të Vendimit të datës 26.

Ankesa e tanishme kundër Vendimit të AK-së të datës 26.08.2026 është paraqitur brenda afatit ligjor për ankim pranë OSHP-së, ndërsa llogaritja e këtij afati është paraqitur në pikën 6 të kësaj ankese.

Pretendimi ankimor nr-1

Kërkesa disproporcionale dhe kufizuese lidhur me angazhimin e tre (3) teknikëve të diplomuar të ndërtimtarisë me së paku pesë (5) vite përvojë profesionale

Autoriteti Kontraktues, në kuadër të Kërkesës nr. 1, pika **h)**, ka përcaktuar si kriter të kapacitetit teknik dhe profesional kërkesën:

“Tre (3) Teknikë të diplomuar të ndërtimtarisë, me së paku 5 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit.”

Konsiderojmë se kërkesa e lartcekur është **e tepruar, joproporcionale me objektin dhe vlerën e kontratës dhe ka efekt kufizues ndaj konkurrencës**, përkatësisht nuk është arsyetuar nevoja objektive për angazhimin e pikërisht tre (3) teknikëve të ndërtimtarisë, secili me minimum pesë (5) vite përvojë profesionale.

Vlera e parashikuar e këtij aktiviteti të prokurimit është **329,000.00 euro**. Krahas kërkesës për tre teknikë të ndërtimtarisë, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar tashmë staf të konsiderueshëm profesional, përfshirë:

- një (1) Menaxher të Projektit – Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv, me së paku 5 vite përvojë;
- një (1) Udhëheqës të Punishtes – Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv, me së paku 3 vite përvojë;
- si dhe inxhinierë dhe personel tjetër profesional të hidroteknikës, elektroteknikës, gjeodezisë dhe profileve tjera të kërkuara në Dosjen e Tenderit.

Në këto rrethana, Autoriteti Kontraktues nuk ka paraqitur ndonjë arsyetim teknik që të dëshmojë se për realizimin e kontratës është e domosdoshme që, përveç Menaxherit të Projektit dhe Udhëheqësit të Punishtes – që të dy inxhinierë të ndërtimtarisë – të angazhohen edhe **tre teknikë të tjerë të ndërtimtarisë njëkohësisht**, dhe që secili prej tyre detyrimisht të posedojë së paku pesë (5) vite përvojë pas diplomimit.

Në Dosjen e Tenderit nuk është përcaktuar se ekzistojnë **tri punishte të veçanta, tri fronte të pavarura pune apo tri procese ndërtimore që duhet të realizohen paralelisht**, të cilat do ta arsyetonin domosdoshmërinë e angazhimit të tre teknikëve të ndërtimtarisë.

Përcaktimi i një numri të caktuar të personelit profesional nuk mund të bëhet në mënyrë arbitrare, por duhet të jetë rezultat i nevojave reale për realizimin e kontratës dhe duhet të ekzistojë një raport i arsyeshëm ndërmjet kompleksitetit, vlerës dhe vëllimit të kontratës dhe kapacitetit profesional që kërkohet nga operatorët ekonomikë.

Kërkesa në fjalë është në kundërshtim me **nenin 51 të Ligjit për Prokurimin Publik**, sipas të cilit kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen vetëm në kriteret e nevojshme për të siguruar që operatorët ekonomikë posedojnë aftësitë profesionale, financiare dhe teknike të nevojshme për realizimin e kontratës. Në veçanti, **neni 51 paragrafi 3 i LPP-së** përcakton se të gjitha kriteret e përzgjedhjes, dokumentet dhe informatat e kërkuara duhet të jenë **drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës**.

Gjithashtu, sipas **nenit 69 të LPP-së**, Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë dëshmi për kualifikimet minimale vetëm kur kërkesat dhe dokumentet përkatëse janë relevante dhe të nevojshme për realizimin e kontratës.

Kërkesa kontestuese duhet të shqyrtohet edhe në raport me **nenin 7 të LPP-së – Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi**, i cili obligon Autoritetin Kontraktues që operatorët ekonomikë t'i trajtojnë në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe ndalon zhvillimin e aktivitetit të prokurimit në mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën.

Përveç dispozitave të LPP-së, kërkesa e kontestuar nuk është në harmoni as me **Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 002/2024.**

Në veçanti, **neni 25.17** përcakton se:

“Të gjitha kërkesat minimale për kualifikim do të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë.”

Në rastin konkret, kërkesa për tre (3) teknikë të ndërtimtarisë me nga pesë (5) vite përvojë, përveç dy inxhinierëve të ndërtimtarisë të kërkuar tashmë në pozitat kryesore të projektit, nuk është arsyetuar në raport me vëllimin, kompleksitetin dhe nevojat konkrete të kontratës.

Po ashtu, **neni 25.18 i Rregullores** obligon Autoritetin Kontraktues që gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim t'i kushtojë rëndësi zhvillimit të operatorëve ekonomikë dhe t'i formulojë këto kërkesa në mënyrë që të mos përjashtohen operatorët ekonomikë që posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike, duke marrë në konsideratë edhe **vlerën e parashikuar të kontratës** dhe përdorimin e drejtë të fondeve publike.

Në këtë rast, duke marrë parasysh vlerën e parashikuar prej **329,000.00 euro**, si dhe faktin se kërkohej tashmë Menaxheri i Projektit dhe Udhëheqësi i Punishtes, që të dy inxhinierë të ndërtimtarisë, kërkesa shtesë për tre teknikë me nga pesë vite përvojë paraqet një nivel të kapacitetit profesional për të cilin AK nuk ka dhënë arsyetim konkret dhe proporcional.

Në mënyrë plotësuese, **nenet 19.3, 19.4 dhe 19.5 të Rregullores Nr. 001/2022**, si dhe **neni 19.16 i riformuluar me Rregulloren Nr. 002/2024**, përforcojnë parimin që kërkesat dhe specifikimet në dokumentet e tenderit duhet të hartohen në mënyrë jo-diskriminuese, të jenë të qarta dhe të mos përmbajnë kufizime të paarsyeshme që kufizojnë konkurrencën.

Në veçanti, **neni 19.4** kërkon që përshkrimi i specifikimeve teknike dhe termave të referencës të jetë i qartë, i saktë dhe preciz dhe **të mos paraqesë kufizime të paarsyeshme që kufizojnë konkurrencën**. Ndërsa **neni 19.16**, i riformuluar me Rregulloren Nr. 002/2024, kërkon që gjatë hartimit të specifikimeve teknike të deklarohet se ato janë të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për operatorët ekonomikë dhe se nuk janë hartuar në mënyrë që favorizojnë apo diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomikë.

Edhe pse **nenet 19.3, 19.4, 19.5 dhe 19.16** lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me hartimin e specifikimeve teknike, parimet e përcaktuara në to për **mosdiskriminim, qasje sa më të gjerë dhe shmangie të kufizimeve të paarsyeshme** duhet të respektohen gjatë hartimit të tërësishëm të dokumentacionit të tenderit.

Në rastin konkret, kërkesa kumulative për **tre (3) teknikë të diplomuar të ndërtimtarisë me nga pesë (5) vite përvojë**, duke pasur parasysh se në të njëjtën kontratë janë kërkuar

edhe dy inxhinierë të ndërtimtarisë në pozitat kryesore të Menaxherit të Projektit dhe Udhëheqësit të Punishtes, krijon barrë të panevojshme për operatorët ekonomikë dhe redukton numrin e operatorëve që mund të konkurrojnë, pa u dëshmuar se një kufizim i tillë është domosdoshmërisht i lidhur me realizimin me sukses të kontratës.

Vetë fakti që Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të kërkojë personel teknik nuk nënkupton se mund të përcaktojë çfarëdo numri të personelit. **Numri, kualifikimi dhe përvoja e kërkuar duhet të jenë proporcionalë me nevojën konkrete të kontratës.**

Në këtë rast, nuk është argumentuar pse **një (1) teknik i ndërtimtarisë**, nën drejtimin e Menaxherit të Projektit dhe Udhëheqësit të Punishtes, nuk do të ishte i mjaftueshëm për realizimin e punimeve dhe pse është e domosdoshme kërkesa për pikërisht tre teknikë me nga pesë vite përvojë.

Kërkesa drejtuar Autoritetit Kontraktues

Kërkojmë që pika **h)** të ndryshohet dhe të përcaktohet si vijon:

“Një (1) Teknik i diplomuar i Ndërtimtarisë, me përvojë profesionale të

Kërkesa disproporcionale dhe kufizuese lidhur me angazhimin e dy (2) teknikëve të diplomuar të Elektroteknikës me së paku pesë (5) vite përvojë profesionale

Pretendimi ankimor nr-2

Autoriteti Kontraktues, në kuadër të Kërkesës nr. 1, pika **i)**, ka përcaktuar si kriter të kapacitetit teknik dhe profesional kërkesën:

“Dy (2) Teknikë të diplomuar të Elektroteknikës me së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale pas diplomimit.”

Konsiderojmë se kërkesa e lartcekur është **e tepruar, joproporcionale me objektin dhe vlerën e kontratës dhe ka efekt kufizues ndaj konkurrencës**, pasi nuk është arsyetuar nevoja objektive për angazhimin e pikërisht dy (2) teknikëve të elektroteknikës, secili me minimum pesë (5) vite përvojë profesionale.

Vlera e parashikuar e këtij aktiviteti të prokurimit është **329,000.00 euro**. Krahas kërkesës për dy teknikë të elektroteknikës, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar tashmë edhe:

- një (1) Inxhinier të diplomuar të Elektroteknikës (ose Master), me së paku pesë (5) vite përvojë profesionale pas diplomimit, të pajisur me licencë përkatëse;
- si dhe personel tjetër profesional dhe teknik të profileve të ndryshme, sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit.

Në këto rrethana, Autoriteti Kontraktues nuk ka paraqitur ndonjë arsyetim teknik që të dëshmojë se, për realizimin e punimeve elektrike të kësaj kontrate, përveç inxhinierit të diplomuar të elektroteknikës, është e domosdoshme të angazhohen edhe **dy teknikë të elektroteknikës njëkohësisht**, dhe që secili prej tyre detyrimisht të posedojë së paku pesë (5) vite përvojë profesionale pas diplomimit.

Në Dosjen e Tenderit nuk është përcaktuar se ekzistojnë **dy fronte të veçanta dhe të pavarura të punimeve elektrike që duhet të realizohen paralelisht**, të cilat do ta arsyetonin domosdoshmërinë e angazhimit të dy teknikëve të elektroteknikës.

Përcaktimi i numrit të personelit profesional dhe teknik duhet të bazohet në nevojat reale të kontratës dhe duhet të ekzistojë një raport i arsyeshëm ndërmjet kompleksitetit, vlerës dhe vëllimit të punimeve dhe kapacitetit profesional që kërkohet nga operatorët ekonomikë.

Kërkesa në fjalë është në kundërshtim me **nenin 51 të Ligjit për Prokurimin Publik**, sipas të cilit kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen vetëm në kriteret e nevojshme për të siguruar aftësinë profesionale, financiare dhe teknike të operatorëve ekonomikë. Në veçanti, **neni 51 paragrafi 3** kërkon që kriteret e përzgjedhjes dhe dokumentet e kërkuara të jenë **drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me lëndën e kontratës**.

Gjithashtu, sipas **nenit 69 të LPP-së**, Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë dëshmi lidhur me aftësinë teknike dhe profesionale vetëm kur ato janë relevante dhe të nevojshme për realizimin e kontratës.

Kërkesa kontestuese duhet të shqyrtohet edhe në raport me **nenin 7 të LPP-së – Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi**, i cili ndalon zhvillimin e aktivitetit të prokurimit në mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën ose diskriminon operatorët ekonomikë.

Përveç dispozitave të LPP-së, kërkesa e kontestuar bie ndesh edhe me **Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 002/2024**.

Në veçanti, **neni 25.17** përcakton se:

“Të gjitha kërkesat minimale për kualifikim do të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë.”

Ndërsa **neni 25.18** obligon AK-në që kërkesat minimale të kualifikimit t’i formulojë në mënyrë që të mos përjashtohen operatorët ekonomikë që posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme teknike, duke marrë në konsideratë edhe **vlerën e parashikuar të kontratës** dhe përdorimin e drejtë të fondeve publike.

Në rastin konkret, kërkesa për **dy (2) teknikë të Elektroteknikës me nga pesë (5) vite përvojë**, krahas një Inxhinieri të diplomuar të Elektroteknikës me pesë vite përvojë, nuk është arsyetuar se është proporcionale me vlerën prej **329,000.00 euro**, vëllimin e punimeve elektrike dhe organizimin konkret të projektit.

Në mënyrë plotësuese, duhet të merren në konsideratë edhe **nenet 19.3, 19.4 dhe 19.5 të Rregullores Nr. 001/2022**, të cilat kërkojnë që specifikimet të hartohen në mënyrë jo-diskriminuese, të jenë të qarta dhe të mos përmbajnë kufizime të paarsyeshme që kufizojnë konkurrencën. Veçanërisht **neni 19.4** përcakton se kërkesat nuk duhet të paraqesin kufizime të paarsyeshme ndaj konkurrencës.

Po ashtu, **neni 19.16**, i riformuluar me Rregulloren Nr. 002/2024, kërkon që specifikimet të jenë të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për operatorët ekonomikë dhe të

mos hartohen në mënyrë që favorizojnë apo diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomikë.

Në rastin konkret, kërkesa kumulative për **dy (2) teknikë të diplomuar të Elektroteknikës me nga pesë (5) vite përvojë**, duke pasur parasysh se kërkohet njëkohësisht edhe një Inxhinier i diplomuar i Elektroteknikës me së paku pesë (5) vite përvojë profesionale, krijon barrë të panevojshme për operatorët ekonomikë dhe redukton konkurrencën, pa u dëshmuar se ky numër është domosdoshmërisht i nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës.

Vetë fakti që Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të kërkojë personel teknik nuk nënkupton se mund të përcaktojë një numër të personelit pa arsyetim objektiv. **Numri, kualifikimi dhe përvoja e kërkuar duhet të jenë proporcionalë me nevojën konkrete të kontratës.**

Në këtë rast, nuk është argumentuar pse **një (1) teknik i elektroteknikës**, nën drejtimin dhe përgjegjësinë profesionale të Inxhinierit të Elektroteknikës, nuk do të ishte i mjaftueshëm për realizimin e punimeve elektrike dhe pse është e domosdoshme kërkesa për dy teknikë me nga pesë vite përvojë profesionale.

Kërkesa drejtuar Autoritetit Kontraktues

Kërkojmë që pika **i)** të ndryshohet dhe të përcaktohet si vijon:

“Një (1) Teknik i diplomuar i Elektroteknikës, me përvojë profesionale të përshtatshme pas diplomimit.”

Pretendimi ankimor nr-3

Kërkesa për grumbullimin fizik të të gjitha pajisjeve dhe mekanizimit në një seli/depo të vetme është joproporcionale, kufizuese dhe në kundërshtim me mënyrën e dëshmimit të kapacitetit teknik

Autoriteti Kontraktues, në kuadër të **Kërkesës 4**, ka përcaktuar që Operatori Ekonomik duhet t'i ketë pajisjet dhe mekanizimin e paraqitur sipas listës përkatëse fizikisht në selinë e vet, në një vend të vetëm brenda Kosovës, me qëllim të verifikimit fizik nga komisioni i vlerësimit. Njëkohësisht është përcaktuar se, nëse gjatë vizitës nuk gjenden të gjitha pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas Aneksit 7, OE do të shpallet i papërgjegjshëm.

Në anën tjetër, në pjesën **“Dëshmia 4 – Dëshmitë për pronësi, posedim dhe shfrytëzim të mjeteve dhe pajisjeve teknike”**, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar se OE mund të paraqesë dëshmi për pajisjet që **“ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion (në pronësi ose me qira)”**, duke pranuar edhe kontratat apo marrëveshjet e qirasë për pajisjet e nevojshme për realizimin e projektit.

Këto dy kërkesa krijojnë **kundërthënie brenda vetë Dosjes së Tenderit**. Në njërën anë pranohet që pajisjet mund të jenë në pronësi, me qira apo të vihen në dispozicion të OE-së, ndërsa në anën tjetër kërkohet që të gjitha ato të zhvendosen dhe të grumbullohen fizikisht në një depo apo seli të vetme të OE-së vetëm për qëllime të verifikimit.

Kjo kërkesë nuk është në përputhje me mënyrën se si **neni 69 i LPP-së** e përcakton dëshmimin e aftësisë teknike dhe profesionale. Për kontratat e punëve, neni 69.6.3 parashikon raportin për mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë **në dispozicion të operatorit ekonomik për realizimin e projektit të punëve**, pa vendosur kusht që ato të jenë fizikisht të grumbulluara në një lokacion të vetëm.

Po ashtu, **neni 69.8 i LPP-së** përcakton se një OE, kur është e përshtatshme dhe për një kontratë të veçantë, mund të mbështetet edhe në kapacitetet e subjekteve të tjera, me kusht që të dëshmojë se do t'i ketë burimet e nevojshme në dispozicion për ekzekutimin e kontratës.

Rrjedhimisht, kriteri ligjor është **disponueshmëria reale e pajisjeve për ekzekutimin e kontratës**, dhe jo vendndodhja e tyre fizike në një depo të vetme në fazën e tenderimit.

Një pajisje mund të jetë në pronësi ose ligjërish në dispozicion të OE-së, por në momentin e verifikimit mund të ndodhet në pronën e qiradhënësit, në një depo tjetër, në servis, në një projekt tjetër apo në një lokacion tjetër brenda territorit të Republikës së Kosovës. Vetëm fakti se pajisja nuk ndodhet në selinë e OE-së nuk dëshmon se OE nuk e posedon apo nuk e ka atë në dispozicion për realizimin e kontratës.

Kërkesa kontestuese bie gjithashtu në kundërshtim me **nenin 51 të LPP-së**, i cili kërkon që kriteret e përzgjedhjes të kufizohen vetëm në ato që janë të nevojshme për të dëshmuar aftësinë profesionale, financiare dhe teknike të operatorit ekonomik. Në veçanti, **neni 51 paragrafi 3** përcakton që kriteret e përzgjedhjes dhe dokumentet e kërkuara duhet të jenë **drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me lëndën e kontratës**.

Gjithashtu, **neni 7 i LPP-së – Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi** ndalon që Autoriteti Kontraktues të zhvillojë një aktivitet prokurimi në mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën ose krijon kushte diskriminuese ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Kërkesa e kontestuar është problematike edhe në raport me **Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 002/2024**.

Në veçanti, **neni 25.17** përcakton se të gjitha kërkesat minimale për kualifikim duhet të jenë **drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës**, ndërsa **neni 25.18** kërkon që kriteret minimale të formulohen në mënyrë që të mos përjashtohen operatorët ekonomikë që posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme teknike.

Në rastin konkret, kushti që pajisjet të jenë të gjitha të grumbulluara fizikisht në një depo apo seli të vetme nuk dëshmon ndonjë kapacitet teknik shtesë të OE-së. OE mund t'i posedojë dhe t'i ketë plotësisht në dispozicion pajisjet e kërkuara edhe kur ato ndodhen në lokacione të ndryshme.

Në mënyrë plotësuese, **neni 19.4 i Rregullores** kërkon që specifikimet dhe kërkesat të mos paraqesin kufizime të paarsyeshme që kufizojnë konkurrencën, ndërsa **neni 19.16**, i riformuluar me Rregulloren Nr. 002/2024, kërkon që specifikimet të hartohen në mënyrë që të sigurojnë qasje sa më të mirë për operatorët ekonomikë dhe të mos favorizojnë apo diskriminojnë një ose më shumë OE.

Kërkesa bëhet edhe më joproporcionale për shkak se OE njoftohet vetëm **48 orë para vizitës**. Për pajisje dhe mekanizim që mund të jenë të angazhuara në lokacione të ndryshme, një kërkesë e tillë e detyron OE-në t'i zhvendosë dhe grumbullojë artificialisht

vetëm për qëllim të verifikimit, duke krijuar kosto, ndërprerje të angazhimeve ekzistuese dhe barrë administrative që nuk lidhet me aftësinë reale të OE-së për realizimin e kontratës.

Po ashtu, konsiderojmë joproporcionale dispozitën për **eliminimin automatik të OE-së** vetëm për faktin se një pajisje nuk gjendet fizikisht në selinë apo depon e tij gjatë vizitës. Duhet bërë dallim ndërmjet rastit kur OE realisht nuk e posedon apo nuk e ka në dispozicion pajisjen dhe rastit kur pajisja ekziston, është ligjërish në dispozicion të OE-së për realizimin e kontratës, por fizikisht ndodhet në një lokacion tjetër.

Në këto rrethana, verifikimi fizik mund të realizohet pa cenuar qëllimin e Autoritetit Kontraktues, duke i mundësuar OE-së të deklarojë paraprakisht lokacionet ku ndodhen pajisjet dhe duke i mundësuar komisionit që t'i verifikojë ato në **lokacionet reale brenda territorit të Republikës së Kosovës**.

Kërkesa drejtuar Autoritetit Kontraktues

Kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të ndryshojë **Kërkesën 4**, duke **hequr kushtin që të gjitha pajisjet dhe mekanizimi të jenë fizikisht të grumbulluara në një depo apo seli të vetme të OE-së**, si dhe të largohet kushti për **eliminimin automatik të OE-së** vetëm për faktin se ndonjë pajisje nuk gjendet në atë lokacion gjatë vizitës.

Të lejohet që pajisjet dhe mekanizimi që OE i ka **në pronësi, me qira apo në dispozicion për realizimin e kontratës të mund të ndodhen në lokacione të ndryshme brenda territorit të Republikës së Kosovës**, me kusht që OE të dëshmojë disponueshmërinë e tyre dhe t'i mundësojë Autoritetit Kontraktues verifikimin fizik në lokacionet ku ato realisht ndodhen.

Pretendimi ankimor nr-4

Kërkesa disproporcionale dhe kufizuese lidhur me kërkesën për dy (2) kamionë specialë për bartjen e mbeturinave deri në 3.5 ton peshë totale

Autoriteti Kontraktues, në kuadër të kërkesave për pajisjet dhe mekanizimin e nevojshëm për realizimin e kontratës, ka përcaktuar kërkesën:

“Kamionë specialë për bartjen e mbeturinave deri në 3.5 ton, me peshë totale – 2 copë.”

Konsiderojmë se kërkesa për posedimin apo disponimin e **dy (2) kamionëve specialë për bartjen e mbeturinave** është e tepruar, joproporcionale me natyrën dhe vëllimin e kontratës dhe ka efekt kufizues ndaj konkurrencës, pasi Autoriteti Kontraktues nuk ka paraqitur arsyetim teknik konkret që dëshmon domosdoshmërinë e angazhimit të dy kamionëve njëkohësisht.

Bartja dhe largimi i mbeturinave është aktivitet që mund të organizohet sipas fazave dhe dinamikës së realizimit të punimeve. Përmbushja e këtij aktiviteti nuk varet domosdoshmërisht nga disponimi i dy kamionëve në të njëjtën kohë, pasi **një (1) kamion i përshtatshëm mund të realizojë numrin e nevojshëm të transporteve gjatë zhvillimit të punimeve**.

Në Dosjen e Tenderit nuk është arsyetuar se ekzistojnë dy fronte të veçanta pune që kërkojnë transport paralel të mbeturinave, as nuk është paraqitur ndonjë analizë e volumit të mbeturinave, frekuencës së transportit apo dinamikës së punimeve që do të dëshmonte se një kamion i vetëm nuk është i mjaftueshëm.

Për më tepër, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar **Sigurinë e Ekzekutimit me afat validiteti jo më pak se 775 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës**. Vetë ky afat nuk provon kohëzgjatjen e punimeve, mirëpo, në mungesë të një arsyetimi të veçantë për urgjencë ose nevojë për transport të njëkohshëm në dy fronte, nuk mund të përdoret si bazë për të justifikuar kërkesën për dy kamionë. Nevoja për dy mjete duhet të rezultojë nga vëllimi dhe dinamika reale e punimeve, dhe jo vetëm nga përcaktimi numerik i pajisjeve.

Kërkesa e kontestuar duhet të vlerësohet në raport me **nenin 51 të LPP-së**, i cili kërkon që kriteret e për zgjedhjes të kufizohen vetëm në ato që janë të nevojshme për të dëshmuar aftësinë profesionale, financiare dhe teknike të OE-së. Në veçanti, **neni 51 paragrafi 3** përcakton se kriteret e për zgjedhjes dhe dokumentet e kërkuara duhet të jenë **drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me lëndën e kontratës**.

Gjithashtu, **neni 69 i LPP-së** lejon kërkimin e dëshmive për aftësinë teknike dhe profesionale vetëm kur ato janë relevante dhe të nevojshme. Për kontratat e punëve, neni 69.6.3 i referohet mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë në dispozicion të OE-së për realizimin e projektit.

Po ashtu, kërkesa duhet të shqyrtohet në raport me **nenin 7 të LPP-së – Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi**, i cili ndalon që aktiviteti i prokurimit të zhvillohet në mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën ose vendos kërkesa që favorizojnë apo diskriminojnë operatorët ekonomikë.

Kërkesa e kontestuar bie ndesh edhe me **Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 002/2024**.

Në veçanti, **neni 25.17** përcakton se të gjitha kërkesat minimale për kualifikim duhet të jenë **drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës**, ndërsa **neni 25.18** kërkon që kërkesat minimale të formulohen duke pasur parasysh aftësitë e arsyeshme dhe të mjaftueshme teknike të OE-ve, vlerën e parashikuar të kontratës dhe përdorimin e drejtë të fondeve publike.

Në mënyrë plotësuese, **neni 19.4 i Rregullores** kërkon që specifikimet dhe kërkesat të mos përmbajnë kufizime të paarsyeshme që kufizojnë konkurrencën, ndërsa **neni 19.16**, i riformuluar me Rregulloren Nr. 002/2024, kërkon që specifikimet teknike të hartohen në mënyrë që të sigurojnë qasje sa më të mirë për operatorët ekonomikë dhe të mos favorizojnë apo diskriminojnë një ose më shumë operatorë.

Në rastin konkret, pa një analizë apo arsyetim teknik që demonstroi nevojën për përdorimin e dy kamionëve paralelisht, kërkesa për **dy (2) kamionë specialë** krijon kapacitet shtesë të paarsyetuar dhe mund të kufizojë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë që janë plotësisht të aftë ta realizojnë kontratën me **një (1) kamion**, përmes organizimit të transporteve sipas dinamikës së punimeve.

Kërkesa drejtuar Autoritetit Kontraktues

Kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që kërkesën për **dy (2) kamionë specialë për bartjen e mbeturinave deri në 3.5 ton** ta reduktojë në **një (1) kamion**, dhe kriteri të përcaktohet si vijon:

“Një (1) kamion special për bartjen e mbeturinave deri në 3.5 ton, me peshë totale.”

Pretendimi ankimor nr-5

Kërkesa joproportionale, e panevojshme dhe kufizuese lidhur me kërkesën për kamion vetëshkarkues me kran me peshë deri në 3.5 ton

Autoriteti Kontraktues, në kuadër të listës së pajisjeve dhe mekanizimit të detyrueshëm për realizimin e kontratës, ka kërkuar:

“Kamion vetëshkarkues me kran, me peshë deri në 3.5 ton.”

Konsiderojmë se kjo kërkesë është **e panevojshme, joproportionale dhe ka efekt kufizues ndaj konkurrencës**, pasi në të njëjtën listë të pajisjeve Autoriteti Kontraktues ka kërkuar tashmë pajisje transportuese dhe vetëshkarkuese me funksion të njëjtë apo të përafërt.

Konkretisht, në **pozicionin 2** të listës së pajisjeve është kërkuar:

“Kamion vetëshkarkues me kran me peshë bartëse deri në 1 ton.”

Ndërsa në **pozicionin 4** janë kërkuar:

“Kamionë kiper me peshë totale mbi 5 ton – 3 copë.”

Në këto rrethana, kërkesa shtesë për një **kamion vetëshkarkues me kran deri në 3.5 ton** paraqet kapacitet teknik shtesë, funksioni i të cilit në masë të konsiderueshme mbulohet nga mekanizimi tjetër i kërkuar nga vetë Autoriteti Kontraktues.

AK tashmë ka kërkuar një kamion vetëshkarkues me kran për ngarkim dhe transport, si dhe **tre (3) kamionë kiper mbi 5 ton** për bartjen dhe shkarkimin e materialeve. Për këtë arsye, nuk është paraqitur ndonjë arsyetim teknik konkret se cilin proces të veçantë dhe të domosdoshëm të punimeve do ta kryejë kamioni shtesë deri në 3.5 ton, i cili nuk mund të realizohet me pajisjet e tjera të kërkuara.

Kërkimi kumulativ i disa mjeteve me funksione të njëjta ose të përafërta, pa u dëshmuar nevoja për përdorimin e tyre paralel dhe të njëkohshëm, krijon **barrë të panevojshme për operatorët ekonomikë** dhe rrit artificialisht nivelin e kapacitetit teknik që duhet të dëshmohet në fazën e tenderimit.

Kërkesa e tillë duhet të vlerësohet në raport me **nenin 51 të LPP-së**, sipas të cilit kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen vetëm në ato që janë të nevojshme për të dëshmuar aftësinë profesionale, financiare dhe teknike të OE-së. Në veçanti, **neni 51 paragrafi 3** kërkon që kriteret dhe dokumentet e kërkuara të jenë **drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me lëndën e kontratës**.

Gjithashtu, **neni 69 i LPP-së** lejon kërkimin e kapaciteteve teknike vetëm kur ato janë relevante dhe të nevojshme për realizimin e kontratës. Për kontratat e punëve, neni 69.6.3

i referohet mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë në dispozicion të OE-së për realizimin e projektit.

*Kërkesa duhet të shqyrtohet edhe në raport me **nenin 7 të LPP-së – Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi**, i cili ndalon zhvillimin e aktivitetit të prokurimit në mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën ose vendos kërkesa që favorizojnë apo diskriminojnë operatorët ekonomikë.*

*Përveç dispozitave të LPP-së, kërkesa e kontestuar nuk është në harmoni as me **Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 002/2024.***

*Në veçanti, **neni 19.3** kërkon që specifikimet teknike të përcaktojnë karakteristikat e obligueshme të objektit të kontratës në mënyrë **jo-diskriminuese**, ndërsa **neni 19.4** përcakton se specifikimet teknike duhet të jenë të qarta dhe të mos paraqesin **kufizime të paarsyeshme që kufizojnë konkurrencën**.*

*Po ashtu, **neni 19.16**, i riformuluar me Rregulloren Nr. 002/2024, kërkon që specifikimet teknike të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit, të sigurojnë qasje sa më të mirë për operatorët ekonomikë dhe të mos hartohen në mënyrë që favorizojnë ose diskriminojnë një apo më shumë operatorë.*

*Në të njëjtën frymë, **neni 25.17** përcakton se të gjitha kërkesat minimale për kualifikim duhet të jenë **drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës**, ndërsa **neni 25.18** kërkon që AK t'i formulojë kërkesat minimale në mënyrë që të mos përjashtohen OE-të që posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme teknike, duke marrë parasysh edhe vlerën e parashikuar të kontratës dhe përdorimin e drejtë të fondeve publike.*

*Në rastin konkret, duke qenë se Autoriteti Kontraktues ka kërkuar tashmë **kamion vetëshkarkues me kran në pozicionin 2 dhe tre (3) kamionë kiper mbi 5 ton në pozicionin 4**, nuk është dëshmuar nevoja reale dhe teknike për kërkimin edhe të një kamioni tjetër vetëshkarkues me kran deri në 3.5 ton.*

*Kapaciteti teknik duhet të përcaktohet sipas **funksionit dhe nevojës reale të kontratës**, dhe jo përmes kërimit të disa pajisjeve të ndryshme që kryejnë funksione të njëjta apo të ngjashme, nëse nuk ekziston nevojë e arsyetuar për përdorimin e tyre njëkohësisht.*

*Për rrjedhojë, konsiderojmë se kërkesa për **“Kamion vetëshkarkues me kran me peshë deri në 3.5 ton”** paraqet kapacitet teknik shtesë të paarsyetuar dhe krijon kufizim të panevojshëm të konkurrencës.*

Kërkesa drejtuar Autoritetit Kontraktues

*Kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që ta largojë në tërësi nga Dosja e Tenderit kërkesën për **“Kamion vetëshkarkues me kran me peshë deri në 3.5 ton”**, pasi funksioni i kësaj pajisjeje mbulohet nga mekanizimi tjetër i kërkuar, veçanërisht nga **kamioni vetëshkarkues me kran i pozicionit 2 dhe tre (3) kamionët kiper mbi 5 ton të pozicionit 4**.*

Kërkesa joproporcionale, e panevojshme dhe kufizuese lidhur me pajisjen “Lugë ngarkuese 2–3 t”

Autoriteti Kontraktues, në kuadër të listës së pajisjeve dhe mekanizimit të nevojshëm për realizimin e kontratës, ka kërkuar:

“Lugë ngarkuese 2–3 t.”

Konsiderojmë se kjo kërkesë është **e panevojshme, joproporcionale dhe kufizuese ndaj konkurrencës**, pasi në të njëjtën listë të pajisjeve, konkretisht në **pozicionin 11**, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar edhe:

“Lugë ngarkuese 3–7 t – 2 copë.”

Pra, Autoriteti Kontraktues ka paraparë tashmë **dy (2) lugë ngarkuese me kapacitet 3–7 ton**, të cilat kryejnë të njëjtin funksion bazë të ngarkimit, zhvendosjes dhe manipulimit të materialeve dhe kanë kapacitet më të madh se pajisja shtesë “Lugë ngarkuese 2–3 t”.

Në këto rrethana, kërkesa edhe për një **lugë ngarkuese 2–3 ton** paraqet shtim të panevojshëm të kapacitetit teknik, përderisa funksioni i kërkuar mbulohet tashmë nga dy pajisjet me kapacitet 3–7 ton.

Autoriteti Kontraktues nuk ka paraqitur ndonjë arsyetim teknik konkret se cili proces specifik i punimeve kërkon domosdoshmërisht përdorimin e një luge ngarkuese 2–3 ton dhe pse ai proces nuk mund të realizohet nga njëra prej **dy lugëve ngarkuese 3–7 ton** të kërkuara tashmë.

Kërkimi kumulativ i pajisjeve që kryejnë funksion të njëjtë apo të përafërt, pa u dëshmuar nevoja për përdorimin e tyre paralel dhe të njëkohshëm, krijon barrë të panevojshme për operatorët ekonomikë dhe rrit në mënyrë të pajustificuar nivelin e kapacitetit teknik të kërkuar për pjesëmarrje në tender.

Kërkesa e kontestuar duhet të vlerësohet në raport me **nenin 51 të LPP-së**, sipas të cilit kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen vetëm në ato që janë të nevojshme për të dëshmuar aftësinë profesionale, financiare dhe teknike të OE-së. Në veçanti, **neni 51 paragrafi 3** përcakton se të gjitha kriteret e përzgjedhjes duhet të jenë **drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me lëndën e kontratës**.

Gjithashtu, **neni 69 i LPP-së** përcakton se kërkesat për aftësinë teknike dhe profesionale duhet të jenë relevante dhe të nevojshme, ndërsa për kontratat e punëve lejon kërkimin e raportit për pajisjet teknike që janë në dispozicion të OE-së për realizimin e projektit.

Kërkesa bie gjithashtu në raport me **nenin 7 të LPP-së – Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi**, i cili ndalon vendosjen e kërkesave që reduktojnë apo eliminojnë konkurrencën ose krijojnë avantazh apo disavantazh të pajustificuar ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Përveç dispozitave të LPP-së, kërkesa e kontestuar nuk është në harmoni as me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 002/2024.

*Në veçanti, **neni 19.3** kërkon që specifikimet teknike të përcaktohen në mënyrë jo-diskriminuese, ndërsa **neni 19.4** kërkon që ato të mos përmbajnë **kufizime të paarsyeshme që kufizojnë konkurrencën**.*

*Po ashtu, **neni 19.16**, i riformuluar me Rregulloren Nr. 002/2024, kërkon që specifikimet teknike të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit, të sigurojnë qasje sa më të mirë për operatorët ekonomikë dhe të mos favorizojnë apo diskriminojnë një ose më shumë operatorë.*

*Në të njëjtën frymë, **neni 25.17** përcakton se të gjitha kërkesat minimale për kualifikim duhet të jenë **drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës**, ndërsa **neni 25.18** kërkon që AK t'i përcaktojë kërkesat duke marrë parasysh aftësitë e arsyeshme dhe të mjaftueshme teknike të OE-ve, vlerën e kontratës dhe përdorimin e drejtë të fondeve publike.*

*Në rastin konkret, kërkitimi i një **luge ngarkuese 2–3 ton**, përveç **dy (2) lugëve ngarkuese 3–7 ton**, nuk është mbështetur me ndonjë nevojë të veçantë teknike. Për këtë arsye, kërkesa shtesë rezulton joproporcionale dhe krijon kufizim të panevojshëm të konkurrencës.*

Kërkesa drejtuar Autoritetit Kontraktues

*Kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që ta largojë në tërësi nga Dosja e Tenderit kërkesën për “**Lugë ngarkuese 2–3 t**”, pasi në pozicionin 11 janë kërkuar tashmë **dy (2) lugë ngarkuese 3–7 ton**, të cilat kryejnë të njëjtin funksion dhe mbulojnë nevojën teknike për këtë lloj mekanizimi.*

Pretendimi ankimor nr-7

Kërkesa joproporcionale, e panevojshme dhe kufizuese lidhur me pajisjen “Damper 1–3 ton”

Autoriteti Kontraktues, në kuadër të listës së pajisjeve dhe mekanizimit të nevojshëm për realizimin e kontratës, ka përcaktuar edhe kërkesën:

“Damper 1–3 ton.”

*Konsiderojmë se kjo kërkesë është **joproporcionale, e panevojshme dhe kufizuese ndaj konkurrencës**, pasi në të njëjtën listë të mekanizimit Autoriteti Kontraktues ka kërkuar tashmë disa mjete transportuese dhe vetëshkarkuese që mbulojnë funksionin bazë të bartjes dhe shkarkimit të materialeve gjatë realizimit të punimeve.*

Konkretisht, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar:

- *në pozicionin 1: “**Kamion vetëshkarkues me kran, peshë bartëse 2–3 ton – 1 copë**”;*

- në pozicionin 2: “Kamion vetëshkarkues me kran, me peshë bartëse deri në 1 ton – 1 copë”;
- në pozicionin 4: “Kamionë kiper me peshë totale mbi 5 ton – 3 copë.”

Pra, në të njëjtën listë të mekanizimit janë kërkuar tashmë **pesë (5) mjete transportuese/vetëshkarkuese**, të cilat mundësojnë bartjen, transportin dhe shkarkimin e materialeve gjatë realizimit të punimeve.

Në këto rrethana, kërkesa shtesë për “**Damper 1–3 ton**” duhet të mbështetet në një nevojë konkrete dhe të identifikueshme teknike. Autoriteti Kontraktues nuk ka paraqitur arsyetim se cili aktivitet apo proces specifik i punimeve kërkon domosdoshmërisht përdorimin e një damperi të veçantë me kapacitet brenda intervalit 1–3 ton dhe pse ky funksion nuk mund të realizohet me mekanizimin transportues dhe vetëshkarkues të kërkuar tashmë.

Nëse karakteristikat e vendpunishtes, hapësirat e kufizuara, qasja apo ndonjë element tjetër teknik kërkon domosdoshmërisht një pajisje të këtij tipi, një nevojë e tillë duhet të jetë **e arsyetuar dhe e lidhur drejtpërdrejt me punimet konkrete**, dhe jo të përcaktohet si kërkesë shtesë pa shpjeguar funksionin e saj të veçantë.

Kërkimi kumulativ i pajisjeve me funksione të njëjta ose të përafërta, pa u dëshmuar nevoja për përdorimin e tyre të veçantë apo të njëkohshëm, rrit në mënyrë të pajustifikuar nivelin e kapacitetit teknik që duhet të dëshmojë OE dhe mund të kufizojë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë që posedojnë kapacitet të mjaftueshëm për realizimin e kontratës.

Kërkesa e kontestuar duhet të shqyrtohet në raport me **nenin 51 të LPP-së**, sipas të cilit kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen vetëm në kriteret e nevojshme për të siguruar se operatorët ekonomikë posedojnë aftësitë profesionale, financiare dhe teknike të nevojshme për realizimin e kontratës. Në veçanti, **neni 51 paragrafi 3** përcakton se të gjitha kriteret e përzgjedhjes duhet të jenë **drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës**.

Gjithashtu, **neni 69 i LPP-së** lejon që Autoriteti Kontraktues të kërkojë dëshmi lidhur me aftësinë teknike dhe profesionale vetëm kur ato janë relevante dhe të nevojshme. Për kontratat e punëve, neni 69.6.3 i referohet mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë në dispozicion të operatorit ekonomik për realizimin e projektit.

Kërkesa kontestuese duhet të vlerësohet edhe në raport me **nenin 7 të LPP-së – Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi**, i cili ndalon zhvillimin e aktivitetit të prokurimit në mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën ose vendos kërkesa që favorizojnë apo diskriminojnë operatorët ekonomikë.

Përveç dispozitave të LPP-së, kërkesa nuk është në harmoni as me **Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 002/2024**.

Në veçanti, **neni 19.3** kërkon që karakteristikat e obligueshme të përcaktohen në mënyrë jo-diskriminuese, ndërsa **neni 19.4** përcakton se specifikimet teknike duhet të jenë të qarta, të sakta dhe të mos paraqesin **kufizime të paarsyeshme që kufizojnë konkurrencën**.

Po ashtu, **neni 19.5** lejon që kërkesat teknike të formulohen edhe në aspektin e performancës apo kërkesave funksionale. Në këtë kuptim, kur qëllimi real është bartja dhe

shkarkimi i materialeve, kërkesa duhet, sa është e mundur, të lidhet me funksionin që pajisja duhet të realizojë dhe jo me një interval të ngushtë kapaciteti pa arsyetim teknik.

Gjithashtu, **neni 19.16**, i riformuluar me Rregulloren Nr. 002/2024, kërkon që specifikimet teknike të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit, të synojnë qasje sa më të mirë për operatorët ekonomikë dhe të mos favorizojnë apo diskriminojnë një ose më shumë OE.

Në të njëjtën frymë, **neni 25.17** përcakton se të gjitha kërkesat minimale për kualifikim duhet të jenë **drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës**, ndërsa **neni 25.18** kërkon që AK të formulojë kërkesat minimale duke marrë parasysh aftësitë e arsyeshme dhe të mjaftueshme teknike të operatorëve ekonomikë, vlerën e parashikuar të kontratës dhe përdorimin e drejtë të fondeve publike.

Për rrjedhojë, në mungesë të një arsyetimi teknik që dëshmon funksionin e veçantë dhe domosdoshmërinë e **Damperit 1–3 ton**, kërkesa paraqet kapacitet teknik shtesë të paarsyetuar dhe mund të kufizojë në mënyrë të panevojshme konkurrencën.

Kërkesa drejtuar Autoritetit Kontraktues

Kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që ta largojë në tërësi nga **Dosja e Tenderit kërkesën për “Damper 1–3 ton”**, pasi funksioni i bartjes dhe shkarkimit të materialeve mbulohet në masë të konsiderueshme nga pajisjet e tjera transportuese dhe vetëshkarkuese të kërkuara, konkretisht **kamioni vetëshkarkues me kran 2–3 ton, kamioni vetëshkarkues me kran deri në 1 ton dhe tre (3) kamionët kiper mbi 5 ton**, ndërsa nuk është dhënë arsyetim teknik për nevojën e një damperi shtesë.

Në **alternativë**, nëse Autoriteti Kontraktues vlerëson dhe arsyeton se pajisja e tipit Damper është e domosdoshme për realizimin e kontratës, kërkojmë që të **largohet kufizimi i ngushtë “1–3 ton”** dhe kriteri të përcaktohet në mënyrë më të hapur dhe proporcionale, si vijon:

“Damper me kapacitet minimum 1 ton.”

Kjo formulë mundëson pjesëmarrjen edhe të operatorëve që posedojnë damper me kapacitet më të madh, përderisa pajisja përmbush funksionin e kërkuar për realizimin e kontratës.

Kundërpërgjigje ndaj Pretendimit nr. 1 – Tre teknikë të diplomuar të Ndërtimtarisë me së paku pesë vite përvojë

AK në vendimin e datës 26.08.2026 arsyeton në mënyrë të përgjithshme se personeli i kërkuar është i nevojshëm për realizimin e kontratës, se OE-të mund ta angazhojnë stafin përmes marrëveshjeve dhe se operatorët mund të paraqiten edhe në grup duke bashkuar kapacitetet.

Ky arsyetim **nuk i përgjigjet pretendimit tonë ankimor.**

Pretendimi ynë nuk ka qenë se është juridikisht e pamundur të angazhohen tre teknikë apo se OE nuk mund të bashkojë kapacitete me operatorë të tjerë.

Çështja konkrete është:

Pse janë të nevojshëm pikërisht tre (3) teknikë të diplomuar të ndërtimtarisë dhe pse secili prej tyre duhet të ketë së paku pesë (5) vite përvojë profesionale, kur në të njëjtin aktivitet janë kërkuar edhe Menaxheri i Projektit dhe Udhëheqësi i Punishtes, që të dy inxhinierë të ndërtimtarisë?

AK nuk ka identifikuar:

- tri fronte të veçanta pune;
- tri punishte që duhet të funksionojnë paralelisht;
- tri procese ndërtimore të pavarura;
- detyra konkrete që kërkojnë tre teknikë njëkohësisht;
- ose ndonjë analizë tjetër teknike që arsyeton numrin tre dhe kushtin prej pesë viteve për secilin.

Fakti se një OE mund të punësojë personel shtesë ose të formojë grup operatorësh nuk e bën automatikisht një kriter proporcional.

Përkundrazi, proporcionaliteti duhet të vlerësohet në raport me nevojën konkrete të kontratës dhe jo me mundësinë teorike të operatorit për ta përmbushur një kriter të caktuar.

*Prandaj, konsiderojmë se AK në vendimin e datës 26.08.2026 **nuk e ka rrëzuar pretendimin tonë**, sepse nuk ka dhënë asnjë arsyetim teknik lidhur me domosdoshmërinë e tre teknikëve.*

Kërkojmë që ky pretendim të aprovohet dhe kriteri të reduktohet në një nivel të arsyeshëm dhe proporcional.

Kundërpërgjigje ndaj Pretendimit nr. 2 – Dy teknikë të diplomuar të Elektroteknikës me së paku pesë vite përvojë

Në vendimin e AK-së nuk rezulton një analizë e veçantë dhe e individualizuar e këtij pretendimi.

Arsyetimi i përgjithshëm se personeli mund të angazhohet përmes marrëveshjeve ose përmes grupit të operatorëve nuk i përgjigjet pyetjes konkrete të ngritur nga ankuesi.

AK ka kërkuar:

- një Inxhinier të diplomuar të Elektroteknikës/Master, me së paku pesë vite përvojë dhe licencë përkatëse; dhe
- njëkohësisht dy Teknikë të diplomuar të Elektroteknikës, secili me së paku pesë vite përvojë.

AK nuk ka shpjeguar:

- pse nevojiten pikërisht dy teknikë;
- pse një teknik nën drejtimin e inxhinierit përgjegjës nuk do të ishte i mjaftueshëm;

- cilat janë dy fronte të veçanta të punimeve elektrike që kërkojnë angazhimin paralel të tyre;
- dhe pse secili teknik duhet të ketë pikërisht pesë vite përvojë.

*Pra, edhe në këtë pikë, AK ka shpjeguar **si mund të plotësohet kriteri**, por jo **pse kriteri është i nevojshëm**.*

Këto janë dy çështje krejtësisht të ndryshme.

Mundësia për ta plotësuar një kriter përmes punësimit, qirasë së kapaciteteve apo grupit të OE-ve nuk e përjashton detyrimin që vetë kriteri të jetë relevant, i nevojshëm dhe proporcional me objektin e kontratës.

Për këtë arsye kërkojmë aprovimin e këtij pretendimi dhe ndryshimin e kriterit në mënyrë proporcionale.

Kundërpërgjigje ndaj Pretendimit nr. 3 – Grumbullimi fizik i të gjitha pajisjeve në një seli/depo të vetme

AK arsyeton se operatorë të ndryshëm mund të paraqesin makineri të cilat nuk i kanë në dispozicion ose nuk janë funksionale dhe se, për këtë arsye, kërkohet grumbullimi i makinerive në një depo të vetme, me njoftim të OE-së së paku 48 orë përpara.

Ne nuk e kundërshtojmë të drejtën e AK-së për të verifikuar nëse pajisjet ekzistojnë, janë funksionale dhe janë realisht në dispozicion të operatorit.

*Kontestohet vetëm **mënyra joproporcionale e verifikimit**.*

Dosja e Tenderit vetë lejon që pajisjet të jenë:

- në pronësi;
- me qira; ose
- në dispozicion të OE-së përmes marrëveshjeve përkatëse.

Në këto rrethana, është plotësisht e mundshme që një pajisje e marrë me qira të ndodhet në selinë e qiradhënësit, në një projekt tjetër, në servis apo në një lokacion tjetër, ndërsa megjithatë të jetë ligjërisht dhe realisht në dispozicion të OE-së për realizimin e kontratës.

Prandaj, ekziston dallim esencial ndërmjet:

a) pajisjes që OE nuk e posedon dhe nuk e ka në dispozicion; dhe

b) pajisjes që OE e ka ligjërisht në dispozicion, por që në momentin e kontrollit fizik ndodhet në një lokacion tjetër.

AK në vendimin e vet nuk e trajton këtë dallim.

Kërkesa që të gjitha pajisjet të transportohen artificialisht në një depo të vetme vetëm për kontroll, brenda një periudhe prej 48 orësh, krijon kosto transporti, ndërprerje të aktivitetëve tjera dhe barrë administrative që nuk dëshmon kapacitet teknik shtesë.

Qëllimi i AK-së mund të arrihet me një masë dukshëm më pak kufizuese: OE të deklarojë lokacionin real të secilës pajisje dhe AK ta verifikojë atë aty ku ndodhet.

Në këtë mënyrë ruhet plotësisht e drejta e AK-së për kontroll fizik, por pa imponuar kushtin artificial që të gjitha makineritë të jenë në një vend të vetëm.

Gjithashtu, argumenti i AK-së se kriteri zbatohet njësoj për të gjithë operatorët nuk është i mjaftueshëm. Një kusht mund të zbatohet formalisht njësoj për të gjithë dhe përsëri të jetë joproporcional dhe kufizues ndaj konkurrencës.

Prandaj kërkojmë largimin e kushtit për grumbullimin e të gjitha pajisjeve në një seli/depo të vetme, duke ruajtur të drejtën e AK-së për verifikim fizik në lokacionet reale të pajisjeve.

Kundërpërgjigje ndaj Pretendimit nr. 4 – Dy kamionë specialë për bartjen e mbeturinave deri në 3.5 ton

AK në vendimin e saj thekson se makineritë mund të sigurohen edhe me qira apo përmes grupit të operatorëve dhe se kërkesa është vendosur për sigurimin e kapacitetit të nevojshëm për bartjen e mbeturinave gjatë realizimit të kontratës.

Edhe ky arsyetim nuk e adreson pretendimin tonë.

Ne nuk kemi pretenduar se operatori nuk mund t'i marrë dy kamionë me qira.

Pretendimi ynë është:

Pse kontrata kërkon pikërisht dy (2) kamionë të tillë njëkohësisht?

AK nuk ka paraqitur në vendimin e saj:

- vëllimin e parashikuar të mbeturinave;
- numrin e transporteve të nevojshme;
- frekuencën e transportit;
- dy fronte pune që kërkojnë transport paralel;
- analizë të dinamikës së punimeve;
- ose ndonjë fakt tjetër teknik që dëshmon se një kamion nuk është i mjaftueshëm.

*Deklarata e përgjithshme se kamionët janë “të nevojshëm për bartjen e mbeturinave” nuk dëshmon nevojën për **dy kamionë**.*

Pikërisht numri dy është objekt i pretendimit tonë dhe pikërisht ky element nuk është arsyetuar nga AK.

Bartja e mbeturinave mund të organizohet sipas fazave dhe dinamikës së punimeve dhe një kamion mund të kryejë disa cikle transporti.

Prandaj kërkojmë që kriteri të reduktohet nga dy kamionë në një kamion, përveç nëse AK paraqet një analizë konkrete teknike që dëshmon domosdoshmërinë e përdorimit paralel të dy mjeteve.

Kundërpërgjigje ndaj Pretendimit nr. 5 – Kamion vetëshkarkues me kran deri në 3.5 ton

Për pretendimet V, VI dhe VII, AK ka dhënë një përgjigje të përbashkët, duke deklaruar se pajisjet janë kërkuar sipas pozicioneve të paramasës dhe parallogarisë dhe se për secilën makineri janë përcaktuar pesha minimale dhe maksimale.

Një arsyetim i tillë është i pamjaftueshëm.

Fakti se një parametër është i shkruar qartë në Dosjen e Tenderit nuk dëshmon se ai është i nevojshëm ose proporcional.

Në rastin konkret, AK ka kërkuar ndër të tjera:

- kamion vetëshkarkues me kran me peshë bartëse deri në 1 ton; dhe
- tre kamionë kiper me peshë totale mbi 5 ton.

Në këto rrethana, AK duhet të tregojë konkretisht:

Cilin proces të veçantë të punimeve do ta kryejë kamioni vetëshkarkues me kran deri në 3.5 ton, i cili nuk mund të kryhet nga pajisjet tjera të kërkuara?

Vendimi nuk jep përgjigje.

Referimi i përgjithshëm në paramasë dhe parallogari nuk identifikon asnjë pozicion konkret të punimeve, as vëllimin e tyre, as nevojën për përdorimin e njëkohshëm të këtyre pajisjeve.

Për këtë arsye, kërkojmë largimin e kësaj kërkesë ose arsyetimin e saj konkret teknik në raport me punimet që duhet të kryhen.

Kundërpërgjigje ndaj Pretendimit nr. 6 – Lugë ngarkuese 2–3 ton

AK nuk ka dhënë arsyetim të veçantë për domosdoshmërinë e pajisjes “Lugë ngarkuese 2–3 t”, por është kufizuar në deklaratën e përgjithshme se parametrat e makinerive janë përcaktuar sipas paramasës dhe parallogarisë.

Në të njëjtën listë AK ka kërkuar edhe:

dy (2) lugë ngarkuese 3–7 ton.

Të dy llojet e pajisjeve kryejnë funksionin bazë të ngarkimit, zhvendosjes dhe manipulimit të materialeve.

Prandaj, nuk mjafton të thuhet se secila pajisje ka peshë minimale dhe maksimale të përcaktuar.

AK duhet të shpjegojë:

- cili proces konkret kërkon posaçërisht lugën 2–3 ton;

- pse ai proces nuk mund të realizohet me njërën nga dy lugët 3–7 ton;
- nëse ekziston kufizim fizik i vendpunishtes, hapësirës ose qasjes;
- dhe pse nevojiten të tri pajisjet njëkohësisht.

Asnjë nga këto elemente nuk është dhënë në vendimin e AK-së.

Prandaj, kërkojmë largimin e pajisjes shitesë “Lugë ngarkuese 2–3 t”, përderisa AK nuk dëshmon funksionin e saj të veçantë dhe të domosdoshëm.

Kundërpërgjigje ndaj Pretendimit nr. 7 – Damper 1–3 ton

Të njëjtën mangësi e ka vendimi edhe lidhur me pajisjen “Damper 1–3 ton”.

AK ka kërkuar tashmë disa mjete për bartjen dhe shkarkimin e materialeve, ndër të tjera:

- kamion vetëshkarkues me kran 2–3 ton;
- kamion vetëshkarkues me kran deri në 1 ton;
- tre kamionë kiper mbi 5 ton.

Në këto rrethana, AK duhet të identifikojë funksionin specifik që mund ta kryejë vetëm Damperi 1–3 ton dhe jo pajisjet e tjera.

Vendimi i datës 26.08.2026 nuk e jep këtë shpjegim.

Nëse ekzistojnë kushte specifike të vendpunishtes – p.sh. hapësirë shumë e kufizuar, qasje e ngushtë apo nevojë teknike për pajisje më kompakte – AK duhet t'i identifikojë dhe arsyetojë konkretisht.

Nuk është e mjaftueshme që pas kundërshtimit të kriterit të thuhet vetëm se pesha minimale dhe maksimale është përcaktuar në Dosjen e Tenderit.

Një parametër teknik duhet jo vetëm të jetë i qartë, por edhe i nevojshëm, relevant dhe proporcional me punën konkrete që do të realizohet.

Në alternativë, nëse OSHP vlerëson se një Damper është realisht i nevojshëm, kërkojmë që kriteri të formulohet në mënyrë funksionale dhe më të hapur, p.sh.:

“Damper me kapacitet minimum 1 ton.”

Në këtë mënyrë nuk përjashtohen operatorët që posedojnë pajisje me kapacitet më të madh, përderisa ajo e kryen funksionin e kërkuar.

Mangësia e përgjithshme e arsyetimit të Vendimit të AK-së

Nga përmbajtja e Vendimit të datës 26.08.2026 rezulton se AK nuk ka bërë një analizë të individualizuar të secilit pretendim.

Për disa prej pretendimeve është dhënë një përgjigje e përgjithshme lidhur me mundësinë e angazhimit të stafit, ndërsa për pretendimet lidhur me disa makineri është dhënë një përgjigje e vetme, duke u thirrur në paramasë dhe parallogari.

Por objekti i Kërkesës për Rishqyrtim nuk ka qenë paqartësia e kriterëve.

*Objekti i saj ka qenë **domosdoshmëria, proporcionaliteti dhe ndikimi kufizues i tyre në konkurrencë.***

Prandaj ekziston dallim thelbësor ndërmjet pyetjeve:

- “A është kriteri i shkruar qartë?” dhe
- “A është kriteri objektivisht i nevojshëm dhe proporcional?”

Vendimi i AK-së në pjesën më të madhe i përgjigjet pyetjes së parë, ndërsa nuk jep përgjigje të argumentuar për të dytën.

Po ashtu, fakti se një kriter mund të plotësohet përmes qirasë, marrëveshjeve ose grupit të operatorëve nuk është provë se vetë kriteri është proporcional.

Nëse ky arsyetim do të pranohej si i mjaftueshëm, praktikisht çdo kriter sasior ose teknik do të mund të arsyetohej vetëm me pohimin se operatori mund ta blejë, marrë me qira apo sigurojë nga një subjekt tjetër, pa u vlerësuar fare nëse AK ka nevojë reale për atë kapacitet.

Kjo do ta zbrazte nga përmbajtja kërkesën ligjore për proporcionalitet dhe relevancë të kriterëve të përzgjedhjes.

VENDIM

I. APROVOHET si e bazuar ankesa e OE “N.N.P. CTA” SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit “Renovimi i qendrës kulturore në Partesh”, me nr. të prokurimit 658-26-6534-5-2-1.

II. DETYROHET Autoriteti Kontraktues – Komuna e Parteshit, që të korrigjojë Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit, duke larguar dhe/ose ndryshuar kriteret diskriminuese të kundërshtuara me Kërkesën për Rishqyrtim dhe me këtë ankesë, në mënyrë që kriteret të jenë në përputhje me LPP-në dhe aktet nënligjore të prokurimit publik.

III. DETYROHET Autoriteti Kontraktues, pas korrigjimit të kriterëve, të publikojë ndryshimet përkatëse përmes formularit B54 dhe të zgjasë afatin për dorëzimin e ofertave, duke u mundësuar OE “N.N.P. CTA” SH.P.K., si dhe të gjithë operatorëve të tjerë ekonomikë të interesuar, pjesëmarrje të barabartë dhe ofertim në këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Autoriteti Kontraktues të ndërmarrë të gjitha veprimet e mëtejshme në përputhje me vendimin e OSHP-së dhe legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shkeljet e pretenduara të Autoritetit Kontraktues i kanë shkaktuar dhe vazhdojnë t'i shkaktojnë Operatorit Ekonomik dëme të konsiderueshme materiale dhe ekonomike.

*Si pasojë e kritereve të kundërshtuara dhe pamundësisë për të marrë pjesë në mënyrë të barabartë në këtë aktivitet të prokurimit, Operatori Ekonomik rrezikon të pësojë **humbje të fitimit të pritshëm**, si dhe ka realizuar **shpenzime përgatitore, administrative dhe teknike** lidhur me analizimin e dokumentacionit të tenderit, përgatitjen e kërkesës për rishqyrtim dhe procedurën ankimore.*

Po ashtu, pamundësimi i pjesëmarrjes së barabartë në një procedurë për të cilën Operatori Ekonomik disponon kapacitete dhe përvojë relevante cenon mundësinë e tij për të konkurruar në treg dhe për të realizuar kontrata të natyrës së ngjashme.

*Përveç dëmit financiar, veprimet e kundërshtuara mund të kenë ndikim negativ edhe në **pozicionin dhe reputacionin profesional të Operatorit Ekonomik**, si një kompani me përvojë në fushën e ndërtimit.*

Për këto arsye, konsiderojmë se shkeljet e pretenduara kanë shkaktuar dhe kërcënojnë të shkaktojnë dëme materiale të drejtpërdrejta dhe të matshme për Operatorin Ekonomik.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

- Kopje të **Njoftimit për Kontratë (B05)** për aktivitetin e prokurimit **“Renovimi i qendrës kulturore në Partesh”**, me nr. të prokurimit **658-26-6534-5-2-1**; njoftimi mban datën 06.08.2026.
 - Kopje të **Kërkesës për Rishqyrtim**, të paraqitur më datë **20.08.2026** përmes platformës së e-Prokurimit;
 - Kopje të **Vendimit mbi pezullimin e aktivitetit të prokurimit**, të nxjerrë nga Autoriteti Kontraktues më datë **21.08.2026**;
- Vërejtje:** Të gjitha pretendimet tona mbështeten me fakte që i gjeni të bashkangjitura kësaj ankese por edhe në dokumentacionin e AK

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.